

UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”

FAKULTETI JURIDIK

Studime Master - Civil dhe Pronësor

ABSTRAKT

Tema: Pronësia në ndërmarrje sipas LPDTS dhe Legjislacionit tjetër të Kosovës më veshtrim krahasues

Koncepti i pronësisë, i përfshirë në dispozitat e LPDTS, është i aplikueshëm edhe tek pronësia në ndërmarrje, normalisht këto norma duhet të aplikohen përshtatshëm, duke pas parasysh natyrën e pronësisë në ndërmarrje. Kosova, ka rregulluar çështjen e pronësisë në shoqëri tregtare me Ligjin për Shoqërit Tregtare, i cili përveç se definon llojet e shoqërive tregtare, ka përcaktuar edhe çështjet e pronësisë dhe regjistrimit të tyre, dhe po ashtu edhe çështjen e të drejtave pronësore në ndërmarrje.

Varësisht nga lloji i ndërmarrjes, edhe çështjet e të drejtave pronësore dallojnë. Derisa tek ndërmarrjet individuale, ortakëritë, dhe tek ortakëritë e kufizuara definimi i pronësisë dhe të drejtave që rrjedhin nga ajo, por edhe i detyrimeve, është më pak kompleks, nuk mund të thuhet e njëjta gjë edhe për shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar apo shoqëritë aksionare si ndërmarrje shumë komplekse. Është e pashmangshme që gjatë trajtimit të këtij punimi të mos trajtohen edhe çështjet që kanë të bëjnë me bashkëpronësinë që janë gjerësisht të rregulluara me LPDTS, por edhe ligjin për shoqëritë tregtare.

Prandaj, përmes analizimit të dispozitave ligjore, të ligjit për Pronësinë dhe të drejtat sendore, që rregullon konceptin e pronësisë, Ligjit për Shoqëritë Tregtare, i cili rregullon format e organizimit të shoqërive tregtare, duke përfshirë edhe çështjet që kanë me pronësinë, bashkëpronësinë, bartjen e të drejtave pronësore, trashëgimin e tyre, por edhe detyrimet e pronarëve të ndërmarrjeve, si dhe ligjeve tjera specifike që mundësojnë themelimin dhe funksionim e shoqërive tregtare si

ndërmarrje, synohet të zhvillohet ky punim që konsideroj se përbënë një punë unike në sistemin juridik të Republikës së Kosovës.

Fjalët kyçe: pronësi, ndërmarrje, ligj.

Kandidati:Labinot Gashi

Mentori: Prof.Ass.Dr.Qerkin Berisha